



Abdulmuhsin el-Abadi

Respektimi i dijetarëve dhe përfitimi nga dija e tyre

Respektimi i dijetarëve dhe përfitimi nga dija e tyre.

Ligjëratë e Shejhut të nderuar:

**AbdulMuhsin bin Hamed El
Abbad**

Përktheu:
Lulzim Perçuku

Të gjitha falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve. Salevatet, selamet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Pejgamberin tonë Muhamed, dhe mbi gjithë familjen dhe shokët e tij.

Vërtetë dituria sheriatike (**fetare**) e përfshirë nga Libri i Allahut ('Azze ue Xhel) dhe nga Suneti i të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem) është dituria e vërtetë me të cilën kihet për qëllim kur ajo cekët e pakufizuar (**në Kuran dhe Sunnet**), dhe mbajtësit e së cilës përmenden (**në Kuran dhe Sunnet**) dhe cilësohen se vërtetë

ata janë dijetarë.

Allahu (‘Azze ue Xhel) e dërgoi të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) mëshirë për të gjitha botët, dhe zbriti mbi të Librin **(Kuranin)** dhe Urtësinë **(Sunnetin)**, i cili komunikoi për njerëzit çdo gjë për të cilën ata kanë nevojë, udhëzoi në çdo të mirë dhe paralajmëroi nga çdo e keqe. Allahu përgatiti për të shokë fisnikë, të cilët i nderoi me shoqërimin e tij dhe marrjen e Sheriatit **(Fesë)** nga ai. Kështu ata u vendosën në krye të kolonës së dijetarëve dhe ishin të parët që e pranuan drejtpërdrejtë të vërtetën

dhe udhëzimin nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Ata përkujdeseshin në maksimum në marrjen e kësaj diturie nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duke mos iu ndarë në asnjë moment mexhliseve të tij dhe dëgjimit të haditheve nga ai. Edhe pse nuk ishte e mundur që të gjithë së bashku të frekuentonin këto mexhlise, ata të cilët mungonin në disa mexhlise prezantonin në tjera, deri sa ata të cilët prezantonin në të parat mungonin në këto të fundit. Kështu ata e pranuan Librin e

Allahu (‘Azze ue Xhel) dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), duke e zëvendësuar njëri tjetrin në shkuarjen tek ai. Në këtë mënyrë ata bashkonin mes interesave të tyre të kësaj bote dhe grumbullimit të diturisë së pranuar nga i Dërguari Fisnik (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Është transmetuar nga Umer ibnul Hattabi, radijAllahu ‘anhu, të ketë thënë se ai kishte një komshi prej Ensarëve, me të cilin kishin rënë në ujdë ta zëvendësonin njëri tjetrin në dëgjimin e Shpalljes që i zbriste të Dërguarit të Allahut (sal-

lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), njëri prezantonte një ditë kurse tjetri ditën tjetër. Kur ishte radha e Umer ibnul Hattabit, ai shkonte tek i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dëgjonte prej tij mësimet e asaj dite, e kur kthehej në shtëpinë e tij takohej me komshiun e tij Ensarit, dhe i transmetonte atë që kishte dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Njëjtë vepronte edhe Ensariu kur vinte radha e tij, dëgjonte nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) mësimet e asaj dite nga e Vërteta dhe Udhëzimi, pastaj

kthehej në shtëpinë e tij dhe e njoftonte Umer ibnul Hattabin për diturinë të cilën e kishte dëgjuar dhe grumbulluar atë ditë nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue sellem).

E njëjta është transmetuar edhe nga Ukbe ibën Amir El Xhuhenij, siç ka ardhur në **“Sahihun”** e Muslimit, i cili thotë: **“Ne (sahabët) e zëvendësonim njëri tjetrin në ruajtjen e deveve, kur vinte radha ime i sillja ato në mbrëmje, pastaj shkoja dhe prezantoja në pjesën e mbetur të mexhlisit të të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue**

sel-lem) dhe dëgjoja nga ai atë që kishte mbetur nga mësimi i tij.” Ndërsa nga Ibën Mes’udi, radijAllahu ‘anhu, transmetohet të ketë thënë: “Ne (sahabët) kur i mësonim (përmendësh) dhjetë ajete nga Kurani, nuk i kalonim ato (nuk mësonim tjera) vetëm atëherë kur mësonim domethënien e tyre dhe të vepruarit me to. Në këtë mënyrë e mësuam diturinë së bashku me veprën.”

Kjo ishte gjendja e sahabëve, radij-Allahu ‘anhum, u kujdesën në skajshmëri, dhe dhanë çdo gjë që ishte në mundësinë e tyre për

bartjen e këtij Sheriati (**Feje**) dhe marrjen e tij nga i Përzgjedhuri (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). E kryen obligimin që kishin ndaj saj (**Fesë**), duke e mbartur dhe interpretuar atë të kompletuar dhe të përsosur. Njëkohësisht, ky ishte edhe një prej shkaqeve për epërsinë, privilegjin dhe madhësinë e tyre, sepse vërtetë askush që erdhi pas tyre nuk e njohu të Vërtetën dhe Udhëzimin veçse përmes rrugës së tyre, dhe askujt nuk i arriti Libri (**Kurani**) dhe Suneti veçse duke qenë ata ndërmjetës. Pra, ata ishin ndërmjetës mes Umetit dhe të

Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).

Kështu që, njerëzve nuk iu arriti as edhe gjëja më e vogël nga e Vërteta dhe Udhëzimi veçse përmes rrugës së tyre. Prandaj, cilido që e konsideron veten të panevojshëm për rrugën e tyre nuk ka fituar asgjë nga e Vërteta, mirëpo ka fituar vetëm poshtërim, është privuar **(nga të mirat e Udhëzimit)** dhe ka ndjekur rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve. Kjo sepse myslimanëve pas epokës së sahabëve e deri ditën kur të ndodh Kijameti, u është shkëputur lidhja me të Dërguarin e Allahut

(sallAllahu alejhi ue sel-lem), përveç nëse fillojnë të marrin **(Fenë)** nga sahabët, radij-Allahu ‘anhum.

Për këtë arsye sahabët kanë sevape dhe shpërblime që askujt që erdhi pas tyre nuk i takon t’i ketë, sepse çdokush që erdhi pas tyre përfitoi nga e Vërteta dhe Udhëzimi në të cilin ata udhëzuan. Prandaj sahabëve u takon shpërblimi i njëjtë sikur shpërblimi i cilitdo, që shkakoi i tyre, përfitoi prej kësaj dije dhe kësaj mirësie. Pra, sahabëve u takon shpërblimi i njëjtë si shpërblimet e krejt Umetit Islam, prej fillimit të ekzistimit të

tij e deri kur të bëhet Kijameti. Ky është privilegj madhështor nga Allahu (‘Azze ue Xhel), me të cilin ata dalluan dhe ishin në epërsi ndaj gjithë të tjerëve.

Pas tyre erdhën Tabiunët (**Pasuesit**), të cilët ecën sipas modelit të Sahabëve, duke e marrë të gjithë diturinë të cilën ata e bartën nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Kështu vazhdoi marrja dhe bartja e diturisë, si zinxhiri me hallka të pashkëputura, çdo gjeneratë merrte nga ajo paraprake. U mblodh dhe u ruajt Sunneti, dhe njerëzit arritën ta kuptonin Librin

e Allahut (‘Azze ue Xhel) dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Pra, rruga e pasuar, realiteti i qartë dhe drejtimi i saktë ndër gjenerata ishte: marrja e diturisë nga ata që janë kompetent për të, pra nga dijetarët.

Për këtë arsye këta dijetarë, prej Sahabëve dhe të gjithë atyre që erdhën më pas dhe ecën sipas yrnekut të tyre, u përshkruan në hadith që janë trashëguesit e vërtetë të të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Pra, në hadith ka ardhur se: **“Dijetarët janë trashëguesit e Enbijave**

(Pejgamberëve).

Vërtetë, Pejgamberët nuk lanë trashëgimi asnjë dinar dhe dirhem, mirëpo lanë trashëgimi vetëm diturinë, prandaj cilido që merr prej saj (diturisë së tyre), ai ka marr hise të madhe (të pasurisë së vërtetë)”.

Kjo është gjendja e dijetarëve të këtij Umeti, prej Sahabëve dhe atyre që i pasuan, ata janë Trashëguesit të cilët e trashëguan këtë të Vërtetë, këtë Udhëzim dhe këtë Dituri të Dobishme të cilën, të gjithë ata që erdhën pas tyre, vazhdimisht ia transmetojnë njëri-tjetrit, përfitojnë prej saj, i

përmendin ata me të mira, i lavdërojnë dhe luten për ta.

Gjithashtu Allahu (‘Azze ue Xhel) e shpërblen cilindo që vepron me këtë Dituri të Dobishme të cilën e ka marr përmes rrugës së tyre, mirëpo njëkohësisht i shpërblen edhe ata **(sahabët)** me shpërblim të njëjtë si të këtij i cili përfitoi nga e Vërteta dhe Udhëzimi që erdhi përmes rrugës së tyre. Pra, kështu këta dijetarë, prej sahabëve dhe atyre që erdhën më pas, u bënë Trashëguesit të cilët trashëguan këtë Dituri të Dobishme e që është vet Trashëgimia Pejgamberike.

Ajo që mbetet për këta dijetarë dhe përmes të cilës ata jetojnë pas vdekjes së tyre është kjo Dituri e Dobishme, në grumbullimin, shpërndarjen, përhapjen dhe shkrimin e së cilës ata mbushën tërë kohën e tyre. Sepse njerëzit kur të vdesin, nëse nuk lenë pas tyre ndonjë dituri apo diçka prej kësaj Trashëgimie Pejgamberike, atëherë një kohë të shkurtër pas vdekjes së tyre, ata harrohen dhe nuk përmenden nga të tjerët. Kurse dijetarët kalojnë vite e mote, e ata janë gjallë në gjuhët, mendjet dhe zemrat e njerëzve. Ky është

Edh-dhikrulhasen

(përmendja me të mirë) të cilin Allahu (‘Azze ue Xhel) e bën të mbetet përherë për Evlijatë **(miqtë)** e Tij. Ky është Edh-dhikrulhasen përmes të cilit ata jetuan pas vdekjes së tyre me qindra vite, kur njëkohësisht u harruan të gjithë bashkëkohësit e tyre që nuk jetuan sipas rrugës dhe modelit të tyre.

Ne sot jetojmë në shekullin e pesëmbëdhjetë **(Hixhrij/Hënor)** dhe vazhdimisht dëgjojmë të përmenden shumë prej dijetarëve të Selefrit **(gjeneratave të para)**, vazhdimisht na kalojnë emrat dhe dituria e tyre, duke përfituar nga

ajo dituri, duke u lutur për ta dhe duke kërkuar nga Allahu që t'i mëshiroj ata. Ky është fryti i vërtetë prej Diturisë së Dobishme. Ndërsa cilido që angazhohet në grumbullimin dhe mbledhjen e pasurisë kurse nuk angazhohet në grumbullimin e Diturisë së Dobishme, atëherë këtë nuk e trashëgon askush përveç fëmijëve dhe pasardhësve të tij. Kurse pasardhësit e dijetarëve janë të shumtë dhe nuk kufizohen vetëm brenda një kohe, ata trashëgohen nga kërkuesit e dijes në çdo kohë dhe në çdo vend, duke përfituar nga dituria e tyre dhe duke i

lavdëruar dhe përmendur me të mirë.

Pastaj këta dijetarë, gjendja e të cilëve ishte kjo, dhanë çdo gjë që ishte në mundësinë e tyre për të arritur tek e vërteta, tek dituria e dobishme dhe njohja e dispozitave fetare (**shariatike**), duke bashkuar mes argumentit dhe fikhut (**kuptimit**) të tij. Kjo ishte gjendja e shumicës së tyre, bashkuan mes Fikhut dhe Hadithit, mes njohjes, mësimit përmendsh, grumbullimit të të gjitha Ethereve[1] (**gjurmëve**), dhe fikhut (**kuptimit**) të tyre. Kështu ata u bënë enë në të cilat u ruajt dituria,

dhe gjithashtu ishin të aftë në kuptimin dhe njohjen e saj. Për këtë arsye ata bashkonin mes Diraje (**njohjes, dije**) dhe Rivaje (**transmetimit**), pra, ata nuk i kushtonin rëndësi vetëm njërës duke anashkaluar tjetrën, mirëpo rëndësi i kushtonin bashkimit mes diturisë dhe veprës, mësimit përmendësh të argumenteve dhe fikhut (**kuptimit**) dhe njohjes së tyre.

Pastaj, ata pajtoheshin në disa çështje gjersa nuk pajtoheshin në disa të tjera, dhe ky mospajtim mes tyre ose ishte ihtilaf tenevu' (**mospajtim** **i**

shumëllojshmërisë) ose ishte ihtilaf tedhad **(mospajtim antagonist)**. Sa i përket mospajtimit të shumëllojshmërisë ai nuk ndikonte dhe nuk kishte ngushti në zemrat e tyre **(ndaj tjetrit)**, dhe nuk bën të thuhet ky ia ka qëlluar kurse tjetri ka gabuar, mirëpo të gjithë janë të saktë. Kjo sepse për të gjitha këto mospajtime ka argumente prej Sunnetit, dhe të gjitha janë të hak **(të vërteta)**, prandaj cilido që vepron me njërin prej tyre ka vepruar drejtë, dhe nuk bën ta kundërshtoj apo armiqësoj tjetrin. Si ilustrim për këtë janë thëniet e

ndryshme që janë transmetuar rreth ezanit, lutjeve hyrëse në namaz, teshehudit...etj. Prandaj, veprimi me cilëndo prej këtyre formave, që kanë ardhur dhe janë pohuar në sunet, konsiderohet veprim i drejtë, dhe nuk bën që njëri të konsiderohet i saktë kurse të tjerët të gabuar, mirëpo të gjithë janë të saktë, sepse kjo formë është e vërtetë... kjo tjetra e vërtetë... tjetra e vërtetë..., dhe ky quhet ihtilaf tenevu' (**mospajtim i shumëllojshmërisë**).

Ndërsa sa i përket ihtilaf tedhad (**mospajtimit antagonist**), ka të bëjë kur një dijetar e konsideron

një çështje hallall kurse tjetri haram, një çështje tjetër njëri e konsideron të lejuar kurse tjetri të ndaluar, tjetra çështje bën të veprohet me të ose nuk bën të veprohet... ky pra quhet ihtilaf tedhad. Dhe ky mospajtim **(antagonist)** i cili ndodhte mes tyre ishte rrjedhojë e ixhtihadit[2] të tyre. Pra, ata dhanë çdo gjë që ishte në mundësinë e tyre për njohjen e së vërtetës **(rreth dispozitave fetare)**, dhe çdonjëri arriti në përfundimin e tij **(rreth atyre çështjeve)**, duke ia qëlluar të vërtetës apo duke e gabuar atë. Mirëpo, njëkohësisht **(në të dyja**

rastet) ata marrin një ose dy shpërblime. Nëse dijetari gjatë ixhihadit të tij ia qëllon të vërtetës atëherë ai shpërblehet **(dy herë)** për ixhtihadin e tij dhe për faktin që ia ka qëlluar **(të vërtetës)**, kurse nëse gabon atëherë shpërblehet **(një herë)** për ixhtihadin e tij, kurse i falet gabimi i tij.

Kjo ishte gjendja e selefite **(paraardhësve)** dhe ulemave të këtij umeti, Allahu i mëshiroftë! Ata dhanë çdo gjë që ishte në mundësinë e tyre, duke u vërtitur/qarkulluar mes një apo dy shpërblimeve. Ky është besimi i

obligueshëm **(për çdo mysliman)** karshi tyre. Kurse ky mospajtim që ndodhi mes tyre, dhe të qenët se disave nga ata iu mundësua njohja argumentit dhe marrja prej tij, kurse disa tjerëve nuk iu mundësua kjo, ishte për shkak të sasisë së dijes që kishte arritur tek secili prej tyre. Është e njohur se askush nuk ka arritur, apo ka mundësi, ta përvetësojë gjithë sunetin e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), në mënyrë që të mos i ikë asgjë. Kjo është e pamundur dhe e paarritshme. Kjo, sepse i Dërguari (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem)

fliste/ligjëronte në disa mexhlise, dhe aty mungonin disa nga sahabët, radij-Allahu ‘anhum, prandaj kjo dije nuk iu kishte arritur dhe ishte e fshehtë për ta. Kurse ata që prezantonin e bartnin **(dhe e transmetonin)**. Për këtë, ndodhte që sahabët **(shokët)** e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) dhe në krye të tyre el hulefa er rashidun[3], të përballeshin me ndonjë situatë apo çështje, dhe ata nuk kishin dije prej të Dërguarit të Allahu (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) rreth dispozitës së saj. Në këso raste ata ndaleshin **(nuk merrnin vendim)**

dhe pyesnin sahabët e tjerë. Pastaj, ndonjëri prej tyre vinte dhe tregonte se për këtë çështje ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) të thotë kështu apo ashtu. Ai i cili e dëgjonte, mbështetej dhe vepronte me këtë hadith që i kishte arritur nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Siç është transmetuar për Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin dhe Aliun, radij-Allahu ‘anhum. Secilit nga ata ndodhte që përballje me ndonjë çështje dhe ai të mos ketë dije për të nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem). Pastaj,

pyeste dhe konsultohej me të tjerët, dhe kështu i arrinte argumenti nga sahabiu tjetër i cili e kishte dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem).

Ky ishte Ibën Abasi, radijAllahu ‘anhu, i cili me gjithë se ishte prej depozitave dhe fukahave të sunetit, i orientonte birin dhe robin e tij të shkonin të dëgjonin hadithe prej Ebu Seid El Hudriut, radijAllahu ‘anhu. Kështu, ata orientonin njëri tjetrin, dhe i udhëzonin/këshillonin njerëzit të shkonin tek filan sahabiu të përfitonin nga dija e tij. Krejt kjo,

sepse askush nuk mundi dhe nuk arriti t'i përvetësonte të gjitha hadithet e të Dërguarit të Allahu (sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem). Për më tepër, askush nuk e pretendoi këtë, dhe nuk i lejohet askujt ta pretendojë. Sepse sunetin e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu 'alejhi ue sel- lem) askush nga njerëzit nuk mundë të përfshijë të gjithin, duke mos i ikur as ajo që është transmetuar **(nga të tjerët)** dhe as ajo që u është shmangur atyre. Bile, as sahabët nuk e kishin arritur dhe nuk e pretendonin këtë. Atëherë, është më primare që kjo të jetë e pamundur për ata që

erdhën pas tyre. Mirëpo, siç na u bë e njohur kjo ishte prej shkaqeve të mospajtimeve që ndodhën mes tyre. Për këtë, disa prej atyre **(dijetarëve)** që pasuan selefën **(gjeneratat e para)** e këtij umeti, nëse u vinte ndonjë hadith nga ndonjë rrugë **(transmetim)** që ishte e pasaktë për të, ata e thoshin të kundërtën e këtij argumenti.

Mirëpo me gjithë këtë, ata e kushtëzonin mendimin e tyre me saktësinë e këtij hadithi. Prandaj, thoshin: nëse ky hadith është i saktë, atëherë edhe unë them dhe mendimi im është në atë çfarë aludon ai hadith. Kështu është

transmetuar nga selefi **(të parët)** e këtij umeti, si Shafiu dhe të tjerët. Imam Shafiu, RahimehUllah, shpeshherë thoshte, për disa hadithe: nëse është i saktë, atëherë ky është mendimi im. Njërit nga pasuesit e tij i arriti hadithi dhe tha: hadithi është i saktë, prandaj, ky është edhe medh'hebi i Shafiut. Pra, medh'hebi me të cilin ai e ka kushtëzuar mendimin e tij me saktësinë e hadithit. E, përderisa ai u saktësua atëherë ky është medh'hebi tij. Gjithashtu, Imam Shafiu, RahimehUllah, ka thënë: të gjithë myslimanët kanë konsensus se atij të cilit i është bërë i qartë

një sunet i të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem), nuk i lejohet ta braktisë për fjalën/mendimin e dikujt tjetër, kushdo qoftë ai.

Kjo ishte rruga e tyre, e jepnin tërë mundin (**ixhtihadin**) në njohjen e së vërtetës, pastaj, ndonjëri nga këta muxhtehidë ose ia qëllonte të vërtetës ose e gabonte atë. Mirëpo, siç na u bë e njohur secili prej e fitonte një apo dy shpërblime. Siç, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha: **“Kur gjykatësi (dijetari) bën ixhtihad dhe ja qëllon të vërtetës, ai do t’i ketë dy shpërblime. Mirëpo,**

**nëse bën ixhtihad dhe gabon,
atij i takon një shpërblim.”**

Këto fjalë të të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem), faktojnë se nuk është e thënë që muxhtehidi gjithsesi t’ia qëlloj së vërtetës. Prej tyre ka që ja qëllojnë, por ka nga ata edhe që e gabojnë. Mirëpo, ai që ia qëllon i merr dy shpërblime, kurse ai që e gabon vetëm një. Po, mund të thuhet që çdo muxhtehid e qëllon, d.m.th. e qëllon shpërblimin, edhe pse ata dallojnë sa i përket shpërblimeve. Kurse sa i përket qëllimit të vërtetës, ky hadith e sqaron se mospajtimet që ndodhin

mes tyre dhe që janë të natyrës antagoniste, atëherë e vërteta është vetëm me njërin prej tyre, kurse të tjerët e kanë kundërshtuar atë **(të vërtetë)**. Mirëpo, ai që e ka qëlluar i merr dy shpërblim, kurse ata që e kanë gabuar e marrin vetëm një shpërblim.

Kjo ishte rruga që u pasua në shekullin e parë dhe të dytë, dhe kështu ishte, secili e jepte mundin e tij për të nxjerrë dispozita nga ajo dije që i kishte ardhur. Jepte çdo gjë që ishte në mundësitë e tij dhe arrinte deri të konkluzionet e tij. Mirëpo, ai do shpërblehet gjithsesi. Ky duhet të jetë besimi

ynë sa i përket selefite të këtij umeti, prej sahabëve dhe atyre që erdhën pas tyre, dhe për këdo që eci sipas modelit dhe platformës së tyre. Pra, ata do t'i fitojnë dy shpërblime ose vetëm njërin prej tyre.

Pastaj, është obligim për kërkuesit e dijes dhe ata që i përkasin dijes, t'i respektojnë dijetarët të cilët ecën sipas modelit të tyre **(sahabëve)**. T'i respektojnë duke i dashur ata dhe duke i mbushur zemrat me dashuri ndaj tyre. Duke i madhëruar dhe nderur ashtu siç u takon/shkon atyre. Duke i përmendur me të mira dhe duke i

lavdëruar. Duke e interpretuar çdo që vjen prej tyre në mënyrën më të mirë. Duke besuar se ata janë njerëz, ndonjëherë ia qëllojnë e ndonjëherë gabojnë, dhe kushdo që ja ka qëlluar prej tyre do t'i ketë dy shpërblime, ndërsa kushdo që ka gabuar do ta ketë një shpërblim, kurse gabimi i tij do t'i falet. Ky është obligimi ynë kundrejt tyre. Të mos flitet për ta veçse me të mirë dhe nuk bën të flitet me diçka tjetër. Sepse ai i cili fol për ta me diçka tjetër **(jo me të mira)**, nëse qëllimi i tij është t'i dëmtojë ata apo ta ulë pozitën e tyre, le ta dijë se nuk mund ta

dëmtojë veçse veten e tij. Mirëpo, nëse flitet për ta sqaruar gjendjen e dijetarëve dhe të transmetuesve, a janë të besueshëm, të drejtë, të vërtetë **(në thëniet e tyre)** dhe attribute tjera, atëherë kjo është një çështje që patjetër duhet të zbatohet, dhe veçse e kanë ndjekur këtë rrugë selefi i këtij umeti.

Gjithashtu, nuk duhet të flitet, pa të drejtë, për askënd nga selefi i këtij umeti, sepse me këtë nuk dëmtohet askush tjetër përveç atij që i shqipton dhe i fol ato fjalë. Sa të mira janë fjalët e Ebu Xhafer Et Tahaviut, RahimehUllah, kur fol

për këtë çështje në librin e tij rreth akides (besimit) që quhet “Akidetu Ehlis Sunne uel Xhema.” Ai thotë: “Dijetarët e selefite, prej atyre që paraprinë dhe atyre që i pasuan/ndoqën, pasuesit e lajmeve dhe gjurmëve (haditheve), të zotët e fikhut dhe mendjemprehtësisë, nuk duhet të përmenden ndryshe veçse me të mirë, dhe kushdo që i përmend me të këqija ai nuk është në rrugë (të drejtë)”.

Këto janë fjale të mëdha, të cilat e sqarojnë menhexhin (metodologjinë) që duhet ta

ndjekë kërkuesi i dijës në hakun **(të drejtat)** e selefi të këtij umeti, të cilët harxhuan jetët e tyre dhe shpenzuan edhe përpjekjet e tyre të fundit për mbledhjen, arritjen dhe regjistrimin e kësaj dije, në mënyrë që neve të na vijë e lehtë dhe e gatshme.

Prandaj, neve nuk na mbetet tjetër veçse ta lexojmë atë të cilën ata e regjistruan, dhe të vjelim prej këtyre frutave të gatshëm dhe të pjekur. Ata ishin që e lodhën veten e tyre në grumbullimin, ujitjen, kujdesin dhe ruajtjen e tyre **(frutave)**, derisa na erdhën neve të gatshme, dhe në formën e pamjen

e plotë. Pra, nuk na mbetet neve
veçse të lexojmë dhe të përfitojmë
(nga ajo dije). Prandaj, prej
obligimeve tona ndaj tyre është t'i
lavdërojmë dhe t'i lëvdojmë
(ngremë në qiell) ata. T'i
falënderojmë për mundin e tyre.
T'i përmendim me të mira, dhe që
gjuhët tona vazhdimisht të jenë të
njoma **(lagura)** me përmendjen e
tyre. Zemrat tona të jenë të
mbushura me dashuri ndaj tyre. Të
përfitojmë nga dija e tyre. Ta
njohim vlerën e tyre dhe faktin se
ata ishin që na paraprinë në këtë
hajr **(të mirë)** dhe na e lanë
trashëgimi atë. Kështu që obligim

yni është të tregohemi të kujdesshëm duke u bërë prej trashëguesve të tyre. Të jemi nga hallkat e pandërprera të kësaj trashëgimie, e cila është trashëgimia të cilën sahabët dhe ata të cilët erdhën pas tyre dhe ecën sipas modelit të tyre, e pranuan nga vetë Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel- lem).

Pra, këta dijetarë për të cilët tregova, prej sahabëve dhe atyre që erdhën më pas, janë dijetarët të cilët kam për qëllim që duhet të t'i respektojmë, madhërojmë, lavdërojmë, të përfitojmë prej tyre, t'i përmendim më të mira dhe jo

me diçka tjetër. Pavarësisht a janë prej dijetarëve të hadithit apo prej dijetarëve të fikhut. Siç Imam Tahaviu, RahimehUllah, tha në këtë thënie të madhe: **“Dijetarët e selefit, prej atyre që paraprinë dhe atyre që i pasuan/ndiqën, pasuesit e lajmeve dhe gjurmëve (haditheve)”**, këta janë dijetarët e hadithit. **“Të zotët e fikhut dhe mendjemprehtësisë”**, këta janë dijetarët të cilët u angazhuan me fikh, dhe mbledhjen/regjistrimin e dispozitave të tij. **“Nuk duhet të përmenden ndryshe veçse me të mirë, dhe kushdo që i**

përmend me të këqija ai nuk është në rrugë (të drejtë)”, nuk është në rrugë të qartë dhe në rrugë të drejtë, sepse ai ka devijuar nga ajo. Nuk na lejohej neve që t'i mohojmë/refuzojmë, njollosim apo degradojmë ata të cilët dhanë mundin e tyre në mbledhjen, koleksionimin dhe regjistrimin e kësaj dije, të cilën pastaj na e lanë trashëgim neve. Mirëpo, obligim yni është t'i lavdërojmë, lëvdojmë dhe të përfitojmë prej tyre.

Pastaj vije pyetja: si të përfitojmë nga kjo dije? Cila është e rruga e përfitimit nga ata? U bë e njohur që është obligim respektimi dhe

lavdërimi i tyre, mirëpo si të përfitojmë nga dija e tyre?

Përfitimi nga dija e tyre bëhet duke u kujdesur që t'i kemi/posedojmë librat e dobishme të cilat e përmbajnë këtë dije, të cilën ata na e lanë trashëgim.

Pavarësisht, a është kjo dije të cilën njëri nga ata e mblodhi, apo dikush që erdhi pas tij e regjistroi dhe e mblodhi atë. Përfitojmë nga kjo dije e gatshme, pavarësisht a e mblodhi autori i saj apo dikush tjetër që erdhi pas tij. Kjo arrihet duke i poseduar këto libra të dobishme dhe u munduar të

përfitojmë prej tyre.

Pastaj vije pyetja tjetër: si të përfitojmë nga këto libra? Prej mënyrave të përfitimit është që së pari t'i lexojmë parathëniet e tyre dhe të njihemi me terminologjinë e autorëve. Sepse, në shumicën e rasteve në parathëniet e librave sqarohen terminologjitë, mënyrat **(renditjen)** dhe metodat të cilat këta dijetarë i kishin për qëllim dhe synim në librat e tyre. Ai i cili nuk i lexon këto parathënie nuk mund t'i njohë terminologjitë të cilat përfshihen në to. Prandaj, shpesh ndodh që të hulumtojë për ndonjë gjë jo në vendin e saj. Mendon që

do ta gjejë atë që e kërkon në këto libra, mirëpo, ajo nuk gjendet aty për arsye se nuk hyn në terminologjinë e autorit, të cilën ai e ka sqaruar dhe shpjeguar në këtë libër. Pra, duhet të lexohen parathëniet e librave. Kurse, njohja e terminologjisë së dietarit **(autorit)**, nëse ndonjëri ka terminologji të veçantë, bëhet duke e lexuar dhe ndjekur vazhdimisht punën dhe veprën e tij. Nëse njeriu e njeh terminologjinë e tij atëherë përfiton shumë prej këtij libri. Përndryshe, nëse nuk e njeh atëherë harxhon shumë kohë duke

hulumtuar në libër dhe përfiton shumë pak. Ky libër nuk është vendi për atë dobi apo për atë gjë për të cilën hulumton, sepse, nuk hyn nën terminologjinë e librit dhe nën qëllimin dhe synimin e autorit në përpilimin e këtij libri. Pra, njohja e parathënieve është rruga më e rëndësishme përmes të cilës njeriu përfiton nga dija e këtyre dijetarëve, të cilët e regjistruan këtë trashëgimi, e, që është vetë trashëgimia peygamberike.

Pastaj, prej përfitimeve më të rëndësishme nga këto libra, gjithashtu, është që njeriu duke i lexuar ato, t'i kushtojë rëndësi

regjistrimit të dobive të rëndësishme që i kalojnë. I regjistron ato në skripte (**fletore**) të veçanta. Nëse nuk i regjistron këto dobi atëherë ato humbin. I humbin lexuesit dhe nuk e din ku janë ato. Nëse libri është i përbërë nga shumë vëllime dhe gjatë leximit njeriu kalon afër një dobie, nëse nuk e regjistron, atëherë ai kurrë nuk mundet më ta arrijë këtë dobi (**paskëtaj**). Nuk mund ta dijë ku gjendet, nëse nuk e regjistron menjëherë në vendin ku e ka gjetur. Kjo është prej mënyrave më të dobishme të përfitimit nga libra. Për shembull,

libri “Fet’hul Barij” (komenti i Sahihul Buharij), është i përbërë nga trembëdhjetë vëllime. Në të ka thesare dhe dobi të mëdha. Nëse njeriu kalon pranë këtyre dobive dhe nuk i regjistron ato, atëherë atij mund t’i duhen në një kohë prej kohëve, kështu që humb në këtë deti dhe në këtë oqean. Nuk mund ta gjejë atë përveç nëse lexon apo hulumton shumë në vendet **(librat)** e tij, pastaj ose e gjen ose jo. Harxhon orë të shumta në kërkimin e saj, pastaj ndoshta arrin ta gjej pas një lodhje dhe humbje të madhe të kohës. Përderisa, ka qenë në mundësinë e

tij të përfitoj nga kjo dobi në herën e parë, sikur ta regjistronte në momentin kur e ka lexuar. Pra, kjo është rruga më e rëndësishme që ja mundëson njeriut të fitoj dobi të shumta nga leximi i librave.

Pastaj, njeriu duhet ta veçojë një pjesë të kohës së tij për angazhimin e tij në leximin e librave të dobishme. Kjo të mundëson të arrish dije të madhe dhe të përfitosh nga dija të cilën dijetarët e mëhershëm e regjistruan dhe na e lanë trashëgimi. Kështu që nuk na mbetet tjetër veçse t'i marrin dhe t'i vjelim këto fruta për të cilat

dikush tjetër u lodh në mbledhjen e tyre për ne. Prandaj, neve nuk na mbetet tjetër veçse ta lexojmë këtë që ata e mblodhën për neve dhe na e lanë trashëgim.

Pastaj, kërkuesi i dijes përfiton nga libra të ndryshëm. Nuk është preokupimi i tij të angazhohet me librat e hadithit kurse të jetë i pakujdesshëm ndaj librave të fikhut apo komenteve të cilat përfshijnë çështje të fikhut. Mirëpo, njeriu duhet t'i kushtojë rëndësi çdonjërës nga ato, njohjes së argumentin dhe njohjes së esanidëve **(zinxhirëve të hadithit)**, njohjes së

transmetuesve dhe njohjes së mënyrës përmes së cilës arrihet njohja e vendimeve për hadithet dhe sqarohet se cili prej tyre është autentikë dhe cili i dobët.

Në të njëjtën kohë duhet t'i kushtojë rëndësi njohjes së dispozitave që nxirren nga këto hadithe, dhe thesareve dhe margaritarëve të shtrenjtë të fshehur në to, të cilat nuk ka mundësi t'i arrijë veçse përmes rrugës së meditimit në domethënien dhe kontekstin e tyre.

Gjithashtu, duke i lexuar librat të cilat dijetarët i kanë shkruar në sqarimin e fikhut të këtyre haditheve, çfarë përfitohet dhe çfarë nxirret prej tyre. Kjo është prej gjërave më të rëndësishme për kërkuesin e tyre, të kushtojë rëndësi dispozitave të fikhut dhe atyre të hadithit.

Të mos jetë i kufizuar vetëm në disa fusha të veçanta të cilat kanë të bëjnë me njohjen e transmetuesve dhe të esanideve **(zinxhirëve të hadithit)**, kurse në anën tjetër nuk i njeh çështjet e dispozitave të fikhut. Nëse i ekspozohen atij disa çështje të

fikhut nuk ka haber për to, edhe pse ndoshta ato janë çështje të thjeshta dhe të qarta, sa që një kërkuesi të dijes si ai nuk do të duhej t'i ishin të panjohura. Mirëpo, për shkak të angazhimit të tij me disa anë të dijes është gjykuar për të mosnjohja e të tjerave. Pra, duhet t'i kushtoj rëndësi që të jetë prej atyre që mbledhin nga kjo **(anë)** dhe nga tjetra. T'i kushtoj rëndësi rivajetit **(zinxhirit të hadithit)** dhe dirajetit **(tekstit të tij)**, duke i njohur hadithet dhe fikhun **(kuptimin)** e tyre.

Gjithashtu, duhet t'i lexojë librat e fikhut të cilat i kanë shkruar fukahatë e katër medh'hebeve **(shkollave)**. T'iu referohet dhe të përfitoj nga librat të cilat përmbledhën fikhun e sahabëve **(gjenerata e parë)**, tabiinëve **(gjenerata e dytë)** dhe tabi tabiinëve **(gjenerata e tretë)**. Kjo është rruga përmes të cilës arrihet dija e dobishme dhe përmes së cilës njeriu mundet ta arrij qëllimi, synimin dhe atë që e kërkon.

Gjëja më e rëndësishme për kërkuesin e dijes, në mesin e gjithë kësaj, është organizimi i kohës. Nëse ai e organizon kohën e tij

dhe arrin së paku diçka nga kjo që e thamë për çdo ditë, atëherë pas një kohe ai do të ketë një bagazh të madh të dijes. Një gjë nëse vije çdo ditë, edhe nëse është e pakët, atëherë pasi të kalojnë disa ditë gjatë vitit, do të arrij shumë. Për shembull, nëse çdo ditë e mëson një mesele të fikhut, arrin ta njoh dispozitën dhe përfundimin **(rezultatin)** e saj, atëherë kur të kalojë një vit i plotë **(hënor)** ai do të arrijë t'i njoh, më pak apo më shumë se njëqind e pesëdhjetë e katër mesele.

Mirëpo, neglizhenca, shpërdorimi dhe humbja e kohës në gjëra të kota **(të pavlera)**, kjo është ajo që e humbet dhe nuk lejon të arrihet dija.

Pastaj, dija nuk mund të ruhet deri në perfeksion dhe të vazhdojë të ekzistojë për një kohë të gjatë, veçse me përsëritjen e saj gjatë tërë kohës. Nëse tregohesh neglizhent, i pakujdesshëm dhe angazhohesh me diçka tjetër përveç saj, atëherë ajo humbet, bije dhe dobësohet.

Ekzistenca e saj vazhdon vetëm me përkujtimin e saj dhe jetësimin e kohës me përsëritjen e saj, dhe

duke qenë ajo bisedë e ndejave tona. Kur kërkuesit e dijes takohen, biseda e tyre të mos jetë veçse për një apo më shumë çështje të dijes. Sepse kështu përfitojnë të gjithë, nëse njërit i është fshehur diçka nga dija, e mëson nga tjetri. Buhariu në **“Sahih”** transmeton hadithin i cili është hadithi i parë në kapitullin e **“Modestisë”**, ku Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) thotë:

“Janë dy mirësi për të cilat shumica e njerëzve janë të mashtruar (të pavëmendshëm), shëndeti dhe koha e zbratur (e lënë pa asnjë vepër)”.

Kjo zbrazëtirë është kjo kohë (**e jona**), nëse njeriu nuk e vret duke u angazhuar në arritjen e dijes dhe përsëritjen e saj, mirëpo angazhohet në gjëra të pavlera, atëherë ajo do të jetë ndëshkim për të.

Nëse kërkuesi i dijes është i angazhuar në këtë fushë (**gjëra të kota**), atëherë nuk ka mundësi të arrijë dije, kurse, edhe nëse ka diçka nga dija, atëherë ajo patjetër që do mbarojë dhe do bie (**niveli i saj**). Sepse, arritja e dijes bëhet me angazhim të plotë gjatë tërë kohës. Koha është e shtrenjtë, nëse njeriu nuk e ruan me vepra që i sjellin

hajr, atëherë pronari i saj e humb duke mos përfituar asgjë. Bile, ka mundësi të dëmtohet nëse e jeton/mbush dhe angazhohet me vepra që i sjellin dëme.

Pra, kërkuesi i dijes duhet t'i kushtojë kujdes që tërë kohën e tij të angazhohet në arritjen/grumbullimin dhe regjistrimin e dijes. Kur të takohet me kërkues tjerë të dijes, ta përsërisin së bashku në çdo kohë të përshtatshme. Nuk duhet që kjo të jetë e veçantë vetëm në mexhliet e dijes dhe të derseve (**ligjëratave**), mirëpo, edhe kur takohen në rrugë, në raste të

veçanta, dhe në çdo vend, angazhimi i tyre parësor duhet të jetë hulumtimi dhe përsëritja e dijes. Kjo është rruga/mënyra e shtimit e dijes. Për këtë, një nga dijetarët e këshillonte të birin e tij, që ta ruajë, grumbullojë, dhe vazhdojë dijen. Ia sqaronte vlerën dhe dallimin e kësaj dije ndaj të tjerave, dhe se ajo shtohet dhe rritet me përsëritjen dhe angazhimin me të, kurse, pakësohet me neglizhencë dhe mospërsëritjen e saj. Thotë në këshillën e tij drejtuar birit të vet:

*Thesar për të cilin nuk i frikohesh
ndonjë hajduti I lehtë për t'u bartur, me
ty në është çdo vend.*

Kjo është dija: **“Thesar për të cilin nuk i frikohesh ndonjë hajduti.”** Pasuria plaçkitet dhe shkon, mirëpo dija të cilën e njeriu e ruan me vendosmëri do të mbetet gjithmonë me të. Ai nuk frikësohet se dikush do t'ia marrë **(plaçkitë)** atë, dhe ajo nuk largohet veçse me largimin **(vdekjen)** e tij. Siç edhe vetë Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue sellem) ka thënë: **“Vërtetë Allahu**

nuk e merr (largon) këtë dije
duke e tërhequr (lartë tek Ai),
mirëpo e largon duke i vdekur
(marr) dijetarët.” Poeti tha:

*Thesar për të cilin nuk i frikohesh
ndonjë hajduti I lehtë për t’u bartur, me
ty është në çdo vend Nëse jep shumë nga
ai, shtohet*

Nëse e ndal atë, pakësohet.

“Nëse jep shumë nga ai
shtohet”, d.m.th. njeriu sa më
shumë që e përsëritë dhe flet me
këtë dije (**ajo shtohet**). Sa më
shumë që e përmend (**kujton**) aq

më shumë ajo forcohet dhe qëndron. Mirëpo, nëse kurrë nuk e përsërit, dhe nuk është i kujdesshëm të prezantojë në mexhliet **(ndejat)** e dijes së bashku me kërkuesit e tjerë të dijes, atëherë me kalimin e kohës edhe ajo pak dije që është me të do të harrohet, bie dhe dobësohet. Ky është realiteti.

Nëse shikon në dijen tonë të pakët, dhe pamundësinë tonë për të arritur atë, atëherë e sheh se prej shkaqeve të saj është mosangazhimi ynë që gjatë tërë kohës të mundohemi të grumbullojmë sa më shumë dije

dhe vazhdimisht ta përsërisim atë. Kush dëshiron për veten e tij që të arrijë sa më shumë dije, atëherë kjo është rruga e qartë në arritjen dhe vazhdueshmërinë e saj.

E lus Allahun (‘Azze ue Xhel) që të gjithëve të na jap sukses në arritjen e Kënaqësisë së Tij. Të na jap sukses në arritjen e dijes së dobishme dhe veprimit me të. Të na bëjë udhëzues dhe të udhëzuar. Vërtetë Ai (Tebarake ue Te‘ala) është Bujar dhe Fisnik.

Salevatet, selamet dhe begatitë e Allahut qofshin për krijesën dhe Pejgamberin e të Dërguarin e Tij me të mirë dhe më me vlerë,

Pejgamberin dhe Imamin tonë
Muhamed bin Abdilah, dhe mbi
gjithë familjen dhe shokët e tij.

[1] - Në ethere hyjnë hadithet e
Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue
sel-lem) dhe thëniet e selefit
(gjeneratave të para): sahabët
dhe tabiînët.

[2] - Ixhtihad në terminologjinë
fetare do të thotë: Kur fekihu,
duke u bazuar në argumente të
detajuara **(shtjelluara)**, jep çdo gjë
që është në mundësinë dhe forcën
e tij, për të arritur deri tek një
mendim rreth një dispozite të

caktuar sheriatike.

[3] - Katër kalifët e drejtë që ecën dhe udhëzuan në rrugën e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu alejhi ue sellem). Ata janë: Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu, radij-Allahu ‘anhum.